

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**SKELETKURRIKULI**

**Për Drejtimin Mësimor**

**HOTELERI - TURIZËM**

**Niveli II i KSHK**  
**(2 vjeçar)**

**Kodi: G-II-22**

**Përgatitur me mbështetjen e Programit OeAD (Austri)**

**Miratoi:**

**MINISTRI**

**Tiranë, 2022**

## **Përmbajtja:**

**I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “ Hoteleri - Turizëm”, niveli II i KSHK.**

**II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional “ Hoteleri - Turizëm”, niveli II i KSHK.**

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në drejtimin “Hoteleri-Turizëm”, niveli II i KSHK.
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimimit në drejtimin “ Hoteleri-Turizëm”, niveli II i KSHK.
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimimit në drejtimin “ Hoteleri-Turizëm”, niveli II i KSHK.
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimimit në drejtimin “ Hoteleri-Turizëm”, niveli II i KSHK.

**III. Plani mësimor për drejtimin “ Hoteleri - Turizëm”, niveli II i KSHK.**

**IV. Udhëzime për planin mësimor.**

**V. Udhëzime për procesin mësimor.**

**VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

**VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimimit në drejtimin “Hoteleri - Turizëm”, niveli II i KSHK.**

**VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**

**IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

**X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

## **I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri-Turizëm”, niveli II i KSHK.**

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri-Turizëm”, niveli II i KSHK, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet në fushën e hotelerisë dhe turizmit”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë.
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm.
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi.
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës.
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, si dhe vlerat morale.
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale.
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

## **II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri - Turizëm”, niveli II i KSHK**

### **1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në drejtimin “Hoteleri - Turizëm”, niveli II i KSHK.**

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin mësimor “Hoteleri-Turizëm” niveli II i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar.
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

### **2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në drejtimin “Hoteleri - Turizëm”, niveli II i KSHK.**

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri-Turizëm” niveli II i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efikente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kriteret e drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

### **3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit në drejtimin “Hoteleri - Turizëm”, niveli II i KSHK.**

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri - Turizëm” niveli II i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të përgatitë vendin e punës për gatim dhe shërbim.
- Të dallojë mjedisin, sektorët përkatës, mjetet dhe pajisjet e punës në kuzhinë.
- Të kryejë punë parapërgatitore, sipas sektorëve përkatës.
- Të përdorë dhe mirëmbajë mjetet, pajisjet dhe materialet e punës.
- Të lexojë dhe interpretojë dokumentacionin teknik dhe sinjalistikën e profesionit.
- Të komunikojë në mënyrë etike dhe profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët.
- Të punojë në grup.
- Të zbatojë rregullat e higjienës personale, të mjeteve, pajisjeve dhe vendit të punës, sipas standardit HACCP dhe ISO.
- Të zbatojë standardet e profesionit.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit e dhënies së ndihmës së parë.
- Të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit (mbrojtja e konsumatorit).
- Të zbatojë kushtet e ruajtjes së pijeve dhe ushqimeve sipas llojit.
- Të kryejë përpunime termike në kuzhinë.
- Të përgatitë sallata në kuzhinë.
- Të përgatitë gatime me vezë në kuzhinë.
- Të përgatitë salcat bazë në kuzhinë.
- Të përgatitë buljone dhe supra të thjeshta në kuzhinë.
- Të përgatitë brumëra bazë dhe asortimente me to.
- Të përgatitë asortimente të thjeshta me mish, mish të grirë dhe të brendshme mishi.

- Të përgatitë asortimente të thjeshta me peshk dhe prodhime deti në kuzhinë.
- Të përgatitë salca të ëmbla.
- Të përgatitë kremra bazë në pastičeri.
- Të përgatitë asortimente me perime.
- Të zbatojë rregullat e estetikës në gatim dhe shërbim.
- Të rregullojë dhe shtrojë sallën e shërbimit.
- Të zbatojë rregullat e pritjes, përcjelljes dhe shoqërimit të klientit në restorant.
- Të parapërgatitë shërbimin e pijeve dhe ushqimit në restorant.
- Të kryejë shërbime në restorant dhe dhomën e klientit.
- Të përgatitë dhe shërbejë pije të ngrohta.
- Të ndajë mbeturinat sipas llojit.
- Të shoqërojë klientët drejt recepsionit.
- Të shoqërojë klientët në dhomë dhe ambiente të tjera të hotelit.
- Të transportojë bagazhet e klientëve në dhomë.
- Të informojë klientët për mjediset dhe shërbimet në hotel.
- Të kryejë rezervime të thjeshta sipas kërkesës së klientëve.
- Të kryejë rregjistrimin e klientëve në hotel.
- Të kryejë veprime të thjeshta financiare në recepsion.
- Të kryejë ç’rregjistrimin e klientëve në hotel.
- Të këshillojë klientin për veprimtari kulturore dhe itinerare të thjeshta udhëtimi dhe turistike.
- Të asistojë në shoqërimin e grupit, sipas itinerarit.
- Të lexojë hartat fizike, administrative, turistike dhe rrugore të zonës.
- Të pastrojë dhe rregullojë dhomën, tualetin dhe mjedise të tjera të hotelit.
- Të kryejë procedurat e punës për larjen dhe hekursjen e biankerive.
- Të kryejë procedurat e punës për pastrimin e rrobave të klientit në lavaneri.
- Të komunikojë në gjuhën angleze me klientët gjatë shërbimeve në sektorin e hoteleri turizmit.
- Të kryejë veprimtari që garantojnë cilësinë e përgatitjes dhe shërbimit ndaj klientit.
- Të përdorë teknologjinë dixhitale në mbështetje të veprimtarisë profesionale.

#### **4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtëjshëm në përfundim të arsimimit në drejtimin “Hoteleri – Turizëm”, niveli II i KSHK.**

Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional ”Hoteleri-Turizëm”, niveli II i KSHK, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit gjysmë të kualifikuar (ndihmës) në këtë drejtim. Ky kualifikim i jep nxënësit mundësi t’i drejtohet tregut të punës si ndihmës në sektorin e hoteleri turizmit (bare, restorante, mensa, vetëshërbime agjenci katering, hotele, agjenci turistike, zyra informacioni, spitale, (HORECA) etj).

Pas përfundimit të nivelit të II të KSHK, nxënësi mund të vazhdojë studimet në nivelin e III të KSHK në një prej profileve të drejtimit “Hoteleri-Turizëm”.

Me vijimin e mëtëjshëm të arsimimit profesional edhe në nivelin IV të KSHK, nxënësi fiton ”Maturën shtetore profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare ose pas të mesmes.



**III. Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin “Hoteleri –Turizëm”, niveli II i KSHK.**

<b>Plani mësimor për drejtimin “Hoteleri – Turizëm”, Niveli II i KSHK (2 vjeçar)</b>				
<b>Nr</b>	<b>Kodi</b>	<b>Lëndët dhe modulet mësimore</b>	<b>Orët javore/vjetore</b>	
			<b>Klasa 10</b>	<b>Klasa 11</b>
<b>A.</b>		<b>Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)</b>	<b>14/15</b> (504/ 540)	<b>11/12</b> (374/ 408)
1		Gjuhë shqipe	1	1
2		Letërsi	1	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)	(1)
5		Matematikë	2	2
6		Fizikë	2	-
7		Kimi	-	2
8		Shkenca sociale	2	-
9		Histori	-	2
10		Gjeografi	1	-
11		TIK	1	-
12		Edukim fizik, sporte, shëndet	2	1
<b>B.</b>		<b>Lëndët profesionale (Gjithsej)</b>	<b>6 (216)</b>	<b>6 (204)</b>
1	L-13-442-22	Organizimi i strukturave hoteliere dhe gastronomike	3	-
2	L-13-443-22	Ushqim dhe pije	3	2
3	L-13-036-22	Turizmi dhe mjedisi	-	2
4	L-13-038-22	Trashëgimi kulturore dhe historike	-	2
<b>C.</b>		<b>Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)</b>	<b>8 (288)</b>	<b>11(374)</b>
1	M-13-1348-22	Kuzhinë	108	-
2	M-13-1349-22	Shërbime në restorant	108	-
3	M-13-1350-22	Shërbime në recepsion - 1	36	-
4	M-13-1351-22	Shërbime pastrimi - 1	36	-
5	M-13-1352-22	Kuzhinë dhe pastaçeri	-	204
6	M-13-1353-22	Shërbime në restorant dhe bar	-	68
7	M-13-1354-22	Shërbime në recepsion - 2	-	36
8	M-13-1355-22	Shërbime pastrimi - 2	-	33
9	M-13-1816-22	Komunikimi në gjuhën angleze në hoteleri-turizëm - 1	-	33
<b>D.</b>		<b>Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)</b>	<b>1 (36)</b>	<b>2 (68)</b>
1	M-13-125-20	Shërbimi në pushimet e kafesë	36	-
2	M-13-124-20	Përgatitja e ushqimeve fast – food	36	-
3	M-13-1357-22	Përgatitja menuse me asortimente të zonës, me bazë mishi	-	68

4	M-13-1358-22	Përgatitja e menuesë me asortimente të zonës, me bazë peshku	-	68
5	M-13-127-22	Përgatitja e sallës së restorantit dhe shërbimi për festa	-	68
		Gjithsej A+B+C+D	<b>29/30</b> (1044/ 1080)	<b>30/31</b> (1020/ 1054)

#### IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 10, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (36 javë mësimore).

Në klasën 11 viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 1 javë për provimin e praktikës profesionale + 1 javë për provimin e teorisë profesionale).

Një javë mësimore ka jo më shumë 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikula i arsimit profesional në drejtimin "Hoteleri-Turizëm", niveli II i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orësh ose 6 orësh.

#### V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin tek ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxënësi, është **motivimi i nxënësve**. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është **integrimi i teorisë me praktikën** e profesionit. Parimi i "të nxënësit duke bërë" duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të drejtimit "Hoteleri-Turizëm", niveli II i KSHK.



Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të drejtimit profesional “Hoteleri- Turizëm”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre

## **VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së njëmbëdhjetë, nxënësi i arsimuar në drejtimin profesional “Hoteleri-Turizëm”, niveli II i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar.
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar.

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehjeve, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e hoteleri-turizmit, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, për çdo vit shkollor, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit II të KSHK.

## **VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Hoteleri-Turizëm”, niveli II i KSHK**

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Hoteleri-Turizëm”, niveli II i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:

- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale, për çdo vit shkollor.

- rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit II të KSHK.

## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda “Organizimi i strukturave hoteliere dhe gastronomike”, (L-13-442-22), kl.10–108 orë

#### • Synimet e lëndës “Organizimi i strukturave hoteliere dhe gastronomike”, kl. 10.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Organizimi i strukturave hoteliere dhe gastronomike”, klasa 10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë kuptimin e industrisë së mikpritjes.
- Të përshkruajnë rëndësinë ekonomike dhe sociale të industrisë së mikpritjes dhe lidhjen e saj me turizmin.
- Të dallojë standardet kryesore në industrinë e mikpritjes dhe turizmit.
- Të dallojnë karakteristikat bazë dhe prirjet e industrisë së mikpritjes në turizëm.
- Të përshkruajnë evoluimin e industrisë së mikpritjes, si rrjedhojë e nevojave të klientëve.
- Të përshkruajnë mundësitë për karrierë në industrinë e mikpritjes.
- Të përshkruajnë karakteristikat dhe shërbimet e strukturave akomoduese hoteliere.
- Të dallojnë llojet dhe organizimet e strukturave akomoduese.
- Të përshkruajnë veçoritë e klasifikimit të hoteleve në bazë të vendodhjes, kapacitetit (madhësisë) të strehimit, nivelit të shërbimit që ato ofrojnë, sezonit të funksionimit të tyre, pronësisë etj.
- Të dallojnë veçoritë e kategorizimit të hoteleve sipas legjislacionit shqiptar.
- Të argumentojnë me shembuj format dhe llojet më të zhvilluara të ndërmarrjeve hoteliere e gastronomike, si dhe karakteristikat e tyre në Shqipëri.
- Të dallojnë mjediset kryesore të hotelit dhe vendosjen e tyre në hapësirë.
- Të dallojnë raportet e hapësirave në hotel në funksion të njeriut.
- Të dallojnë llojet e recepsionit, karakteristikat dhe pajisjet e tij sipas strukturës së hoteleve.
- Të dallojnë llojet e dhomave, karakteristikat dhe pajisjet e tyre sipas strukturës së hoteleve.
- Të dallojnë llojet e barit, karakteristikat dhe pajisjet e tij sipas strukturës së hoteleve.
- Të dallojnë llojet e restorantit, karakteristikat dhe pajisjet e tij sipas strukturës së hoteleve.
- Të dallojnë llojet e kuzhinave, karakteristikat dhe pajisjet e tyre sipas strukturës së hoteleve.
- Të dallojnë llojet e sallave të eventeve dhe konferencave, karakteristikat dhe pajisjet e tyre sipas strukturës së hoteleve.
- Të dallojnë llojet kryesore të pajisjeve në administratë dhe në sektorët ndihmës.
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të manualeve të pajisjeve, sipas sektorëve.
- Të dallojnë strukturën organizative të personelit sipas formës së organizimit të hoteleve
- Të përshkruajnë organizimin e departamenteve në hotele, funksionet dhe detyrat e tyre.
- Të përshkruajnë përbërjen, funksionet dhe detyrat e personelit në departamentin e strehimit.
- Të përshkruajnë veprimtaritë e punës në departamentin e strehimit dhe lidhjen me repartet e tjera.
- Të përshkruajnë veprimtaritë e punës në sektorin e recepsionit, administrimit dhe lidhjen me repartet e tjera.
- Të përshkruajnë përbërjen, funksionet dhe detyrat e personelit në departamentin e ushqimit

dhe të pijeve.

- Të përshkruajnë veprimtaritë e punës në bar, restorant dhe kuzhinë dhe lidhjen me repartet e tjera.
- Të përshkruajnë përbërjen, funksionet dhe detyrat e personelit të departamentin e mirëmbajtjes dhe lvanterisë (housekeeping).
- Të përshkruajnë veprimtaritë e punës së mirëmbajtjes dhe lvanterisë dhe lidhjen me repartet e tjera.
- Të përshkruajnë organizimin e punës në sektorët ndihmës dhe lidhjen me repartet e tjera.
- Të përshkruajnë rëndësinë e mirësjelljes zyrtare në industrinë e mikpritjes dhe turizmit.
- Të dallojnë llojet e klientëve në hotel.
- Të përshkruajnë mënyrat e komunikimit dhe etikën e sjelljes në marrëdhëniet me klientët.
- Të përshkruajnë marrëdhëniet dhe rregullat e komunikimit ndërmjet sektorëve në hotel.
- Të identifikojnë rregullat e aftësive të shkruara dhe elektronike të komunikimit.
- Të përshkruajnë efektin e komunikimit verbal dhe joverbal me klientët dhe bashkëpunëtorët.
- Të përshkruajë rëndësinë e komunikimit me terminologji teknike në gjuhë të huaj.
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave e personale të klientëve.
- Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të kulturave dhe traditave të klientëve.
- Të dallojnë funksionin, llojet dhe organizimet e strukturave të ndërmarrjeve gastronomike.
- Të përshkruajnë veçoritë e kategorizimit të ndërmarrjeve gastronomike sipas legjislacionit shqiptar.
- Të përshkruajnë karakteristikat e restorantit, barit jashtë hotelit, sipas ndërtimit të tyre strukturor dhe llojet kryesore të pajisjeve.
- Të dallojnë përbërjen dhe funksionet e personelit të restorantit, barit jashtë hotelit.
- Të përshkruajnë karakteristikat e mensave, fast-food-it, picerive, pastiçerive, kreperive dhe shërbimeve katering sipas ndërtimit të tyre strukturor.
- Të dallojnë përbërjen dhe funksionet e personelit në mensa, fast-food-e, piceri, pastiçeri, kreperi dhe shërbimet katering.
- Të identifikojnë forma të tjera akomoduese të linjave të lundrimit dhe hekurudhore në industrinë e mikpritjes dhe turizmit.
- Të përshkruajnë karakteristikat e restoranteve hekurudhore, detare dhe ajrore.
- Të dallojnë llojet e ndryshme të dokumentacionit teknik që përdoren në strukturat akomoduese dhe gastronomike.
- Të interpretojnë dokumentacionin teknik dhe sinjalistikën e profesionit.
- Të dallojnë mënyrat e inventarizimit fizik të mjeteve, pajisjeve dhe materialeve të punës në hotel, bar, restorant, kuzhinë dhe lvanteri.
- Të dallojnë mjetet dhe format e pagesave në ndërmarrjet hoteliere dhe gastronomike.
- Të dallojnë monedhat e huaja dhe veçoritë e këmbimit valutor, duke kryer veprime me to.
- Të dallojnë llojet e faturave që përdoren në restorant, bar, reception dhe mënyrën e plotësimit të tyre.
- Të dallojnë kuptimin për TVSH- në, si detyrim tatimor dhe element përbërës në plotësimin e faturës.
- Të dallojnë llojet e dokumenteve të shërbimit për klientët në bar, restorant dhe reception mënyrën e plotësimit të tyre.
- Të kryejnë veprime të thjeshta financiare në sektorë të ndryshëm të strukturave akomoduese

dhe gastronomike.

- Të renditin dokumentacionin personal të punonjësit në ndërmarrjet e hotelerisë dhe gastronomisë.
- Të përshkruajnë rolin e kontratës së punës në hoteleri turizëm dhe elementëve të saj.
- Të dallojnë llojet dhe veçoritë e sigurimeve që zbatohen në ndërmarrjet hoteliere dhe gastronomike.
- Të dallojnë mënyrën e llogaritjes së pagës në hoteleri dhe gastronomi sipas rregullave ligjore shqiptare.
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të procedurave për garantimin e cilësisë dhe shëndetit të klientëve në strukturat akomoduese dhe gastronomike.
- Të dallojnë rregullat e higjienës dhe të mbrojtjes së shëndetit të klientëve dhe të punonjësve në ndërmarrjet hoteliere dhe gastronomike.
- Të dallojnë llojet e rreziqeve dhe aksidenteve në strukturat akomoduese dhe gastronomike.
- Të përshkruajnë praktikatat e sigurisë, procedurat e raportimit të aksidenteve dhe dhënies së ndihmës së parë.
- Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes nga zjarri dhe rreziqe të tjera.
- Të dallojnë llojet e ndotjes dhe sigurisë gjatë procesit të trajtimit të ushqimit.
- Të dallojnë llojet dhe format ekologjike të përdorimit të burimeve në strukturat hoteliere dhe gastronomike.
- Të përshkruajnë mënyrat për promovimin e përdorimit racional dhe eko-efikas të burimeve si: uji dhe racionalizimi i tij, energjia dhe efikasiteti i përdorimit të saj. mbeturinat dhe riciklimi, reduktimi dhe menaxhimi i tyre, zhurma, cilësia e ajrit dhe integrimi peizazhit, politika të blerjeve ekologjike, përmirësimi i cilësisë së mjedisit të brendshëm të hotelit etj.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Organizimi i strukturave hoteliere dhe gastronomike”, klasa 10 - 108 orë**

<b>Tema 1</b>	Industria e mikpritjes	6 orë
<b>Tema 2</b>	Ndërmarrjet hoteliere, funksionet dhe klasifikimi i tyre	12 orë
<b>Tema 3</b>	Ndërtimi strukturor, pajisjet dhe mobilimi i hoteleve	15 orë
<b>Tema 4</b>	Struktura organizative. Funksionet dhe detyrat e personelit në hotele	18 orë
<b>Tema 5</b>	Komunikimi në ndërmarrjet hoteliere	9 orë
<b>Tema 6</b>	Ndërmarrjet gastronomike, funksioni dhe klasifikimi i tyre	12 orë
<b>Tema 7</b>	Struktura të tjera akomoduese	6 orë
<b>Tema 8</b>	Dokumentacioni teknik në ndërmarrjet hoteliere dhe gastronomike	14 orë
<b>Tema 9</b>	Dokumentacioni i punonjësve në ndërmarrjet hoteliere	6 orë
<b>Tema 10</b>	Mbrojtja dhe siguria e klientëve në ndërmarrjet hoteliere	6 orë
<b>Tema 11</b>	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm në industrinë e mikpritjes	4 orë

**2. Lënda “Ushqim dhe pije”, (L-13-443-22). Kl. 10 – 108 orë, Kl. 11 – 68 orë**

• **Synimet e lëndës “Ushqim dhe pije”, kl. 10**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Ushqim dhe pije”, kl 10, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë objektin e lëndës “Ushqim dhe pije”.
- Të përshkruajnë evoluimin e teknologjisë së kuzhinës.
- Të dallojnë kërkesat dhe funksionet e profesionit të kuzhinierit si dhe mundësitë për karrierë.
- Të dallojnë veçoritë e mjedisit, pajisjeve dhe mjeteve të punës në kuzhinë.
- Të përshkruajnë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të ruajtjes së mjedisit në vendin e punës.
- Të lexojnë në mënyrë profesionale dokumentacionin teknik në vendin e punës.
- Të dallojnë përbërësit e ushqimeve, vetitë, dhe funksionin e tyre në organizëm. (karbohidratet, proteinat, uji).
- Të dallojnë treguesit cilësorë të produkteve ushqimore në kuzhinë.
- Të dallojnë lëndët e para dhe ato ndihmëse në kuzhinë.
- Të shpjegojnë rëndësinë e hartimit të planit të prodhimit në kuzhinë.
- Të shpjegojnë përbërjen, klasifikimin dhe ruajtjen e drithërave dhe nënprodukteve të tyre.
- Të dallojnë llojet e drithërave dhe nënprodukteve si dhe treguesit cilësorë të tyre për përpunim në kuzhinë.
- Të shpjegojnë përbërjen, klasifikimin dhe ruajtjen e frutave dhe perimeve.
- Të dallojnë llojet e frutave dhe perimeve si dhe treguesit cilësorë të tyre për përpunim në kuzhinë.
- Të shpjegojnë përbërjen, klasifikimin dhe ruajtjen e qumështit dhe nënprodukteve të tij.
- Të dallojnë llojet e qumështit dhe nënprodukteve të tyre, treguesit cilësorë për përpunim në kuzhinë, veçoritë e qumështit që përdoret në bar, defektet dhe kushtet e ruajtjes.
- Të shpjegojnë përbërjen, klasifikimin dhe ruajtjen e vezëve.
- Të dallojnë llojet e vezëve si dhe treguesit cilësorë për përpunim në kuzhinë.
- Të shpjegojnë përbërjen, klasifikimin dhe ruajtjen e mishit të kafshëve, shpendëve dhe nënprodukteve të tyre.
- Të dallojnë llojet e mishit të kafshëve, shpendëve dhe nënprodukteve të tyre si dhe treguesit cilësorë për përpunim në kuzhinë.
- Të dallojnë pjesët e mishit, sipas ndarjes anatomike.
- Të përshkruajnë rregullat e higjienës së ushqimeve në kuzhinë.
- Të dallojnë format dhe shkaqet e helmimeve ushqimore.
- Të dallojnë proceset teknologjike në kuzhinë.
- Të shpjegojnë proceset e përpunimit të ftohtë në kuzhinë.
- Të dallojnë llojet e përpunimit të ftohtë në kuzhinë.
- Të argumentojnë me shembuj procese të përpunimit të ftohtë të produkteve në kuzhinë.
- Të shpjegojnë proceset e përpunimit të nxehtë të produkteve në kuzhinë.
- Të dallojnë llojet e përpunimit të nxehtë në kuzhinë.
- Të argumentojnë me shembuj procese të përpunimit të nxehtë të produkteve në kuzhinë.
- Të dallojnë llojet e brumërave, përdorimin, lëndët e para dhe ndihmëse për përgatitje.
- Të dallojnë llojet e kremrave, përdorimin, lëndët e para dhe ndihmëse për përgatitje.
- Të dallojnë llojet e ëmbëlsirave, përdorimin, lëndët e para dhe ndihmëse për përgatitje.
- Të shpjegojnë rëndësinë e pijeve në gastronomi.
- Të listojnë dhe klasifikojnë pijet.
- Të dallojnë llojet e ujit, veçoritë dhe karakteristikat e tij.
- Të shpjegojnë veçoritë e lëngjeve të frutave dhe të perimeve, llojet, defektet dhe veçoritë e

ruajtjes.

- Të shpjegojnë veçoritë e pijeve freskuese, llojet, defektet dhe kushtet e ruajtjes së tyre.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Ushqim dhe pije”, kl. 10 - 108 orë**

<b>Tema 1</b>	Teknologjia e kuzhinës, objekti, rëndësia, historiku. Personeli, mjedisi, mjetet dhe pajisjet e punës në kuzhinë.	8 orë
<b>Tema 2</b>	Rregullat e higjienës, sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit në kuzhinë. Standartet e sigurimit të cilësisë (HACCP/ISO). Menaxhimi i mbetjeve.	8 orë
<b>Tema 3</b>	Përbërësit e ushqimeve, vetitë, funksioni në organizëm. Treguesit e vlerësimit cilësor të produkteve ushqimore, ambalazhimi dhe etiketat e ushqimeve.	9 orë
<b>Tema 4</b>	Lëndët e para dhe ndihmëse në kuzhinë, klasifikimi.	4 orë
<b>Tema 5</b>	Drithërat, nënproduktet, përbërja, klasifikimi, llojet, treguesit cilësorë, defektet, ruajtja.	5 orë
<b>Tema 6</b>	Frutat dhe perimet, përbërja, llojet, treguesit cilësorë, defektet, ruajtja.	4 orë
<b>Tema 7</b>	Qumështi, nënproduktet, vezët, ëmbëltuesit, tharmet dhe aromatizuesit, përbërja, llojet, treguesit cilësorë, defektet, ruajtja.	6 orë
<b>Tema 8</b>	Mishi i kafshëve dhe shpendëve, therja, ndarja anatomike e mishit sipas llojit, vetitë kimike, nënproduktet, përbërja, llojet, treguesit cilësorë, defektet, ruajtja.	10 orë
<b>Tema 9</b>	Metoda të ruajtjes së ushqimeve në kuzhinë. Mikroorganizmat dhe helmimet ushqimore.	8 orë
<b>Tema 10</b>	Plani i prodhimit në kuzhinë. Proceset teknologjike të përpunimit në kuzhinë. Përpunimi i ftohtë i mishit, perimeve dhe frutave. Marinimi.	12 orë
<b>Tema 11</b>	Përpunimi i nxehtë i produkteve në kuzhinë me zierje, skuqje, pjekje.	8 orë
<b>Tema 12</b>	Përgatitja e salcave në kuzhinë.	4 orë
<b>Tema 13</b>	Brumërat, lëndët e para dhe ndihmëse, përgatitja në kuzhinë.	4 orë
<b>Tema 14</b>	Kremrat në kuzhinë, llojet, lëndët e para dhe ndihmëse. Prodhimi i akullores.	4 orë
<b>Tema 15</b>	Ëmbëlsirat në kuzhinë, llojet, lëndët e para dhe ndihmëse.	4 orë
<b>Tema 16</b>	Pijet, klasifikimi, rëndësia e tyre në ndërmarrjet gastronomike. Uji, llojet e tij, rëndësia e ujit në gastronomi	4 orë
<b>Tema 17</b>	Pijet freskuese, lëngjet e frutave dhe të perimeve, llojet, treguesit cilësorë, ambalazhimi, ruajtja, shërbimi. Etiketimi.	6 orë

- **Synimet e lëndës “Ushqim dhe pije”, kl. 11**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Ushqim dhe pije”, kl 11, nxënësit duhet:

- Të dallojnë përbërësit e ushqimeve, vetitë, dhe funksionin e tyre në organizëm (yndyrat, vitaminat, mineralet).
- Të shpjegojnë përbërjen, klasifikimin dhe ruajtjen e vajrave, yndyrave, nënprodukteve të tyre.
- Të dallojnë llojet e vajrave, yndyrave, nënprodukteve të tyre si dhe treguesit cilësorë për përpunim në kuzhinë.



- Të dallojnë llojet e mishit të kafshëve të egra, shpendëve të egër dhe nënprodukteve të tyre si dhe treguesit cilësorë për përpunim në kuzhinë.
- Të shpjegojnë përbërjen, klasifikimin dhe ruajtjen e peshkut dhe prodhimeve të detit si dhe nënprodukteve të tyre.
- Të dallojnë llojet e peshkut, prodhimeve të detit dhe nënprodukteve të tyre si dhe treguesit cilësorë për përpunim në kuzhinë.
- Të dallojnë llojet e salcave dhe marinadave, përdorimin, lëndët e para dhe ndihmëse.
- Të shpjegojnë përbërjen, klasifikimin dhe ruajtjen e konservave.
- Të dallojnë llojet e konservave si dhe treguesit cilësorë për përpunim në kuzhinë.
- Të shpjegojnë kuptimin e recepturave në kuzhinë.
- Të shpjegojnë përbërjen, klasifikimin dhe ruajtjen e ëmbëltuesve, tharmeve, aromatizuesve.
- Të dallojnë llojet e ëmbëltuesve, tharmeve, aromatizuesve si dhe treguesit cilësorë për përpunim në kuzhinë.
- Të shpjegojnë kuptimin e firove dhe të shtesave ushqimore.
- Të interpretojnë planin e prodhimit në kuzhinë.
- Të shpjegojnë kuptimin për menytë dhe të argumentojnë rëndësinë e tyre.
- Të përshkruajnë veçoritë e menyve të llojeve të ndryshme.
- Të përshkruajnë rëndësinë e kuzhinës shqiptare.
- Të shpjegojnë veçoritë e pijeve me përmbajtje të alkaloidëve (kafe, kakao, çaj), llojet, defektet dhe kushtet e ruajtjes së tyre.
- Të shpjegojnë veçoritë e birrave sipas llojit, defektet, kushtet e ruajtjes dhe shërbimit të tyre.
- Të dallojnë llojet e verës, veçoritë e tyre sipas llojit, defektet dhe kushtet e ruajtjes së tyre.
- Të shpjegojnë veçoritë e pijeve të forta alkoolike (distilate), likereve sipas llojit defektet dhe kushtet e ruajtjes së tyre.
- Të shpjegojnë kuptimin për aperitivët dhe dixhestivët.
- Të dallojnë veçoritë e aperitivëve dhe dixhestivëve sipas llojit.
- Të lexojë në mënyrë profesionale etiketat e pijeve alkoolike dhe joalkoolike.
- Të shpjegojnë mënyrat e përzgjedhjes së pijeve sipas pamjes së jashtme, shijes, aromës, etiketës, llojit të ushqimit.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Ushqim dhe pije”, kl. 11 – 68 orë**

<b>Tema 1</b>	Vajrat, yndyrat, nënproduktet e tyre, përbërja, llojet, treguesit cilësorë, defektet, ruajtja.	6 orë
<b>Tema 2</b>	Mishi i shpendëve dhe kafshëve të egra, nënproduktet, përbërja, llojet, treguesit cilësorë, defektet, ruajtja. Rëndësia e marinimit të mishit të shpendëve të egër.	6 orë
<b>Tema 3</b>	Peshku dhe prodhimet e detit, nënproduktet, përbërja, llojet, treguesit cilësorë, defektet, ruajtja. metodat e konservimit të peshkut.	6 orë
<b>Tema 4</b>	Konservat, llojet, treguesit cilësorë, defektet, ruajtja. Metoda të ruajtjes së ushqimeve në kuzhinë.	5 orë
<b>Tema 5</b>	Përpunimi i ftohtë i peshkut dhe i prodhimeve të detit. Marinimi.	6 orë
<b>Tema 6</b>	Përpunimi i nxehtë i peshkut dhe prodhimeve të detit në kuzhinë (me zierje, skuqje, pjekje)	5 orë
<b>Tema 7</b>	Përgatitja e marinadave. Llojet.	4 orë

<b>Tema 8</b>	Menutë dhe mënyrat e kompozimit të tyre. Rëndësia e tyre në gastronomi.	4 orë
<b>Tema 9</b>	Kuzhina shqiptare, rëndësia, kuptimi, klasifikimi sipas krahinave.	3 orë
<b>Tema 10</b>	Pijet me përmbajtje të alkaloidëve (Kafe, kakao, çaj etj.), llojet, treguesit cilësorë, ruajtja, përgatitja, ambalazhimi, shërbimi, efektet në organizëm.	4 orë
<b>Tema 11</b>	Birrat, lëndët e para dhe ndihmëse për prodhim, llojet, ruajtja, defektet, shërbimi, ambalazhimi dhe etiketat.	4 orë
<b>Tema 12</b>	Vera, origjina, llojet, procesi i vjetërimit, treguesit cilësorë, defektet, ruajtja, ambalazhimi, etiketimi, degustimi, shërbimi.	9 orë
<b>Tema 13</b>	Likeret dhe distilatet, llojet, veçoritë, treguesit cilësorë, ruajtja, ambalazhimi, shërbimi.	4 orë
<b>Tema 14</b>	Aperitivët dhe dixhestivët, rëndësia e tyre, llojet, shërbimi.	2 orë

### 3. Lënda “Turizmi dhe mjedisi”, (L-13-036-22), Kl. 11 – 68 orë

#### • Synimet e lëndës “Turizmi dhe mjedisi”, kl. 11

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Turizmi dhe mjedisi”, kl 11, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin për termat dhe konceptet në fushën e turizmit (turizëm, turist, vizitor, ekskursionist, udhëtim, etj).
- Të shpjegojnë evoluimin e turizmit në etapa të ndryshme.
- Të shpjegojnë rëndësinë social - ekonomike të turizmit për vendin dhe komunitetet që e zhvillojnë atë.
- Të përshkruajnë legjislacionin në fushën e mikpritjes dhe turizmit.
- Të përshkruajnë bazën ligjore për mbrojtjen e konsumatorit.
- Të dallojnë elementët bazë të zhvillimit të turizmit.
- Të dallojnë efektet pozitive edhe negative që sjell zhvillimi i turizmit.
- Të dallojnë sektorët kryesorë dhe ndihmës të industrisë turistike.
- Të vlerësojnë lidhjen e turizmit me bukuritë natyrore, trashëgiminë kulturore dhe historike të vendit, infrastrukturën dhe mikpritjen.
- Të shpjegojnë elementët mbi të cilat zhvillohet turizmi shqiptar.
- Të shpjegojnë faktorët që përbëjnë forcën tërheqëse të burimeve turistike.
- Të shpjegojnë rëndësinë e turizmit si fenomen social në zhvillimin e kohës së lirë.
- Të dallojnë lidhjen mes burimeve natyrore dhe turizmit.
- Të vlerësojnë rëndësinë e aftësive profesionale në sektorin e turizmit.
- Të dallojnë komponentët përbërës dhe format kryesore të produktit turistik.
- Të listojnë karakteristikat e produktit turistik.
- Të vlerësojnë rëndësinë e tregut të atraksioneve turistike në vendin tonë.
- Të klasifikojnë llojet dhe format e turizmit.
- Të përshkruajnë veçoritë e llojeve të ndryshme të turizmit (pushime, biznes, kongrese, turizëm kulturor, trajtim arsimor, sportiv, etj).
- Të përshkruajë veçoritë e turizmit të detit dhe rërës, të interesit të veçantë, turizmin e qytetit dhe të biznesit.



- Të përshkruajë karakteristikat e zhvillimit të turizmit në Shqipëri.
- Të klasifikojnë strukturat e ndërmarrjeve turistike, akomoduese dhe të gastronomisë.
- Të kuptojnë dhe dallojnë marrëdhënien simbiotike midis turizmit dhe mjedisit.
- Të shpjegojnë ndikimin e turizmit në cilësinë e ujit, ajrit, bimësisë, jetën e kafshëve.
- Të shpjegojnë ndikimin e turizmit në disa ekosisteme si: zonat bregdetare, ishujt, malet, etj.
- Të analizojnë faktorët që nxisin industrinë e turizmit drejt zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm dhe të gjelbërt.
- Të shpjegojnë parimet bazë dhe rëndësinë e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm.
- Të vlerësojnë rëndësinë e marrëdhënive të ndërvarura turizëm – mjedis i qëndrueshëm.
- Të shpjegojnë ndikimin e destinacioneve të ndryshme turistike (resorte turistike) në mjedis.
- Të shpjegojnë raportet kundërshtuese të turizmit dhe mjedisit.
- Të shpjegojnë rëndësinë e transportit si faktor i zhvillimit të turizmit.
- Të përshkruajnë efektet e ndotjes së mjedisit nga veprimtari të ndryshme turistike.
- Të vlerësojnë rëndësinë e metodave ekologjike të trajtimit të mbetjeve.
- Të shpjegojë parimet e ekonomisë së gjelbër.
- Të dallojë sektorët në të cilët bazohet ekonomia e gjelbër.
- Të vlerësojë rëndësinë e ekonomisë së gjelbër në ditët e sotme si mjet për zhvillimin e qëndrueshëm.
- Të dallojë turizmin e gjelbër, ekoturizmin dhe turizmin e qëndrueshëm.
- Të listojë llojet e aktiviteteve që mund të zhillohen në turizmin e natyrës (gjelbër) (parqe, plazhe, shpella, male, kodra, ujëvara, ishuj, pyje etj).
- Të listojë llojet e aktiviteteve argëtuese që mund të zhvillohen në sektorin e turizmit (vizita në monumente historike, muzeume, teatër, plazh, hiking/shtigje për ecje, sporte të ndryshme, shfaqje, parqe argëtuese, akuariume, casino etj).
- Të shpjegojë rëndësinë e atraksioneve turistike në turizëm.
- Të evidentojë efektet e turizmit në zhvillimin social të një vendi (mosha, cikli i jetës së familjes, niveli arsimor etj).
- Të dallojë impaktet/ndikimet sociale pozitive të zhvillimit të turizmit (ruajtja e kulturës lokale, forcimi i marrëdhënive të komunitetit, ofrimi i shërbimit social, rivitalizimi i artit dhe kulturës, ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore).
- Të dallojë impaktet/ndikimet sociale negative të zhvillimit të turizmit (sfidat sociale, globalizimi dhe dëmtimi i trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore, humbja e autenticitetit/origjinalitetit/traditave, standardizmi dhe komercializimi, përplasjet midis kulturave të ndryshme, marrëdhëniet e turistëve me komunitetin, rritja e krimit, lojrave të fatit, sjelljeve jo të hijshme etj).
- Të evidentojë ndikimet social-kulturore të turizmit në komunitetin pritës dhe turistin.
- Të analizojë rëndësinë e sigurisë në destinacionet turistike për zhvillimin e një turizmi të suksesshëm dhe të qëndrueshëm.
- Të përshkruajë sfidat me të cilat përballlet industria e turizmit (teknologjia, praktikat miqësore ndaj mjedisit, siguria dhe integriteti, ruajtja e vendeve të punës).
- Të listojë standardet në industrinë turistike.
- Të shpjegojë rëndësinë e standardeve në industrinë e mikpritjes për një turizëm efikas dhe konkures si edhe duke përmirësuar kënaqësinë e turistëve në destinacionet turistike.
- Të analizojë tre shtyllat kryesore të turizmit të qëndrueshëm (mbrojtja e mjedisit, mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, përfitimet sociale - ekonomike për komunitetin).

- Të listojë të drejtat e konsumatorit si turist në vendin tonë.
- Të shpjegojë të drejtat e udhëtarit në bazë të legjislacionit shqiptar.
- Të përkufizojë kuptimin e turizmit të qëndrueshëm sipas UNËTO-s.
- Të përshkruajë qëllimin kryesor të zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm.
- Të listojë parimet e turizmit të qëndrueshëm.
- Të identifikojë përfitimet e turizmit të qëndrueshëm.
- Të analizojë zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm kundrejt turizmit tradicional.
- Të shpjegojë lidhjen ndërmjet turizmit të qëndrueshëm dhe sektorëve të ndryshëm të tij.
- Të shpjegojë rëndësinë ambientale të burimeve turistike për zhvillimin e qëndrueshëm.
- Të shpjegojë rëndësinë e edukimit dhe ndërgjegjësimit ambiental.
- Të përshkruajë rolin e Organizatave kryesore Ndërkombëtare për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.
- Të listojë llojet e ndotjeve që dëmtojnë/pengojnë zhvillimin e turizmit.
- Të analizojë ndikimin e ndotjeve në zhvillimin e turizmit.
- (turisti i gjelbër/turist i përgjegjshëm)

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Turizmi dhe mjedisi”, kl. 11 - 68 orë**

<b>Tema 1</b>	Kuptimi i turizmit dhe rëndësia e zhvillimit të tij	7 orë
<b>Tema 2</b>	Komponentët bazë për zhvillimin e turizmit	11 orë
<b>Tema 3</b>	Llojet dhe format e turizmit	10 orë
<b>Tema 4</b>	Klasifikimi i ndërmarrjeve turistike dhe ndërmjetësit	9 orë
<b>Tema 5</b>	Marrëdhënia turizëm – mjedis	13 orë
<b>Tema 6</b>	Destinacionet turistike dhe ndikimi në mjedis	6 orë
<b>Tema 7</b>	Bashkëveprimi transport – turizëm	5 orë
<b>Tema 8</b>	Turizmi i qëndrueshëm	7 orë

**4. Lënda “Trashëgimi kulturore dhe historike”, (L-13-038-22), Kl. 11 – 68 orë**

• **Synimet e lëndës “Trashëgimi kulturore dhe historike”, kl. 11**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Trashëgimi kulturore dhe historike”, kl 11 nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin mbi trashëgiminë kulturore e natyrore.
- Të tregojnë elementet përbërës të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.
- Të dallojnë llojet e trashëgimisë materiale dhe vlerat e saj.
- Të dallojnë llojet e monumenteve të kulturës sipas vlerave historike arkitekturore dhe mënyrës së vendosjes në një mjedis natyror.
- Të tregojnë vlerat e monumenteve kulturore dhe natyrore shqiptare që janë pjesë e Listës Botërore të Trashëgimisë të UNESCO-s.
- Të identifikojnë qendrat historike si qendra të qytetërimit shqiptar dhe rajonal.
- Të dallojnë elementet e qendrës historike.
- Të përshkruajnë veçoritë e kalave dhe kështjellave kryesore, origjinën dhe historikun e tyre.
- Të përshkruajnë vlerat kulturore dhe natyrore të parqeve kryesore kombëtare arkeologjike shqiptare.

- Të vlerësojnë rëndësinë e tyre si pjesë e trashëgimisë materiale.
- Të vlerësojnë objektet e kultit për historikun, arkitekturën dhe vlerat trashëgimore që përfaqësojnë.
- Të dallojnë tipologjitë e objekteve të kultit sipas llojit të besimit.
- Të dallojnë monumentet kryesore të kultit në Shqipëri.
- Të përshkruajnë ndërtimet popullore, mënyrën e ndërtimit, arkitekturën dhe veçoritë sipas krahinave.
- Të tregojnë ndërtimet më të spikatura me vlerë monumentale.
- Të prezantojnë vlerat e monumenteve kulturore historike pasi të realizojë vizita në to.
- Të klasifikojnë objektet etnografike sipas materialit.
- Të tregojnë vlerat historike, kulturore muzeore të tyre.
- Të vlerësojnë kostumet popullore si kryevepra artistike.
- Të dallojnë tipologjitë e kostumeve të krahinave shqiptare.
- Të përshkruajnë veçoritë e kostumit popullor të zonës.
- Të tregojnë institucionet e trashëgimisë materiale dhe funksionin e tyre.
- Të vlerësojnë kartën shqiptare të restaurimit të monumenteve si dokument ligjor në mbrojtje të vlerave të tyre.
- Të tregojnë llojet kryesore të artit, periudhat e zhvillimit dhe përfaqësuesit kryesor të tyre.
- Të shpjegojnë veçoritë e muzeve si pjesë e trashëgimisë materiale kulturore.
- Të përshkruajnë vlerat historike, artistike, kulturore të muzeve kryesorë të vendit dhe të zonës.
- Të klasifikojnë llojet e muzeve sipas rëndësisë, institucionit që e krijon dhe llojit të objekteve që administrojnë.
- Të vlerësojnë artin e fotografisë si pjesë e trashëgimisë materiale dhe rolin e saj në evidentimin e ngjarjeve historike kulturore.
- Të shpjegojnë kuptimin mbi trashëgiminë shpirtërore, ngjashmëritë dhe ndryshimet me trashëgiminë materiale.
- Të tregojnë përbërësit, vlerat dhe rëndësinë e trashëgimisë shpirtërore.
- Të vlerësojnë rëndësinë e krijimtarisë popullore, llojeve kryesore të saj.
- Të vlerësojnë llojet dhe tipet të isopolifonisë si pjesë të rëndësishme të krijimtarisë gojore shqiptare dhe botërore.
- Të dallojnë karakteristikat e muzikës popullore sipas zonave, elementeve përbërës dhe tematikës.
- Të përshkruajnë karakteristikat e folklorit vokal.
- Të dallojnë tipologjitë e folklorit koreografik dhe veçoritë e tij.
- Të listojnë instrumentat muzikorë popullorë sipas mënyrës së nxjerrjes së tingullit dhe përdorimit të tyre në zona të ndryshme gjeografike.
- Të përshkruajnë karakteristikat e muzikës homofonike të Shqipërisë së Veriut.
- Të përshkruajnë festat dhe zakonet tradicionale shqiptare në krahina të ndryshme.
- Të vlerësojnë aktivitetet dhe Festalet Folklorike Tipologjike Kombëtare që zhvillohen në Shqipëri për vlerat kulturore që ato promovojnë.
- Të përshkruajnë ditët kombëtare dhe botërore të trashëgimisë dhe rëndësinë e festimit të tyre.
- Të vlerësojnë mjedisin si kulturë që kërkon qëndrueshmëri dhe cilësi për të sotmen dhe të

ardhmen.

- Të tregojnë pasojat negative në kulturë nga menaxhimi abuziv i natyrës dhe e kundërta.
- Të shpjegojnë lidhjen midis trashëgimisë, turizmit, mjedisit dhe edukimit ligjor për mbrojtjen e tyre.
- Të tregojnë monumentet kryesore natyrore në Shqipëri dhe kriteret e shpalljes së një pasurie si të tillë.
- Të dallojnë llojet e monumenteve të natyrës dhe veçoritë e tyre.
- Të listojnë kriteret e klasifikimit të zonave të mbrojtura, karakteristikat e tyre.
- Të vlerësojnë rëndësinë e parqeve kombëtare natyrore si pjesë e trashëgimisë natyrore, mjedisore, kulturore.
- Të vlerësojnë rolin e trashëgimisë në mbrojtje të vlerave tradicionale dhe moderne përmes zhvillimit të qëndrueshëm dhe diversitetit kulturor dhe natyror.
- Të vlerësojnë rëndësinë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në zhvillimin e turizmit.
- Të përshkruajnë rëndësinë e gatimeve tradicionale dhe moderne si pjesë e rëndësishme e turizmit kulturor.
- Të tregojnë llojet kryesore të artizanatit shqiptar dhe rëndësinë e tij për zhvillim ekonomik, punësim dhe turizëm.
- Të ndërtojnë një guidë turistike mbi vlerat kulturore dhe natyrore të Shqipërisë.
- Të tregojnë mbresat dhe përjetimet e tyre gjatë një vizite në një monument kulturor ose natyror.
- Të dallojë kontributet pozitive në mbrojtjen e vlerave estetike, social – kulturore dhe biodiversitetit të zonës së tij.
- Të tregojnë rëndësinë e Konventave të UNESCO-s dhe të legjislacionit Shqiptar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore e natyrore ekzistuese dhe të vlerave të reja universale.
- Të përshkruajnë llojet kryesore të turizmit që mund të zhvillohen në Shqipëri duke shfrytëzuar këtë pasuri.
- Të argumentojnë rolin e trashëgimisë materiale, shpirtërore, natyrore në zhvillimin e turizmit kulturor.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Trashëgimi kulturore dhe historike”, kl. 11 - 68 orë**

<b>Tema 1</b>	Trashëgimia kulturore dhe natyrore.	4 orë
<b>Tema 2</b>	Trashëgimia materiale dhe historike. Monumentet.	12 orë
<b>Tema 3</b>	Krijimtaria artistike popullore.	6 orë
<b>Tema 4</b>	Institucionet e trashëgimisë materiale. Muzetë dhe dokumentet arkivore.	12 orë
<b>Tema 5</b>	Trashëgimia shpirtërore. Përbërësit. Institucionet.	4 orë
<b>Tema 6</b>	Krijimtaria popullore shpirtërore.	10 orë
<b>Tema 7</b>	Trashëgimia kulturore dhe mjedisi.	10 orë
<b>Tema 8</b>	Trashëgimia, turizmi dhe legjislacioni.	10 orë

## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

### 1. Moduli “Kuzhinë”

Drejtimi: Hoteleri - Turizëm

Niveli: II i KSHK

Klasa: 10

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe Kodi	KUZHINË	M-13-1348-22
- të zbatojë kushtet për garantimin e cilësisë gjatë përgatitjes së asortimenteve me të brendshme mishi, në kuzhinë;
- të pastrojë vendin e punës;
- të pastrojë, sistemojë, dezinfektojë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e inventarizimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës në kuzhinë;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë përgatitjes së asortimenteve me të brendshme mishi;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë gatimit të asortimenteve me të brendshme mishi;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë në kuzhinë;
- të respostojë procedurat për ndarjen e mbeturinave sipas llojit;
- të zbatojë procedurat për grumbullimin e vajit të përdorur për riciklim.

***Instrumentet e vlerësimit***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 16 Nxënësi përgatit asortimente të thjeshta me peshk.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës;
- të zbatojë rregulloren e brendshme të kuzhinës;
- të parapërgatitë vendin e punës;
- të vërë në funksionim pajisjet e punës në kuzhinë, sipas manualeve të përdorimit;
- të zbatojë planin e prodhimit;
- të përzgjedhë mjetet e punës;
- të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse;
- të vlerësojë cilësinë e peshkut;
- të analizojë recetën përkatëse;
- të peshojë lëndët e para dhe ndihmëse;
- të lajë dhe pastrojë peshkun sipas llojit;
- të heqë luspat (ose lëkurën) e peshkut;
- të heqë velëzat e peshkut;
- të pastrojë peshkun nga të brendshmet;
- të ndajë kokën e peshkut (sipas rastit);
- të kryejë larjen përfundimtare të peshkut;
- të filetojë peshkun (sipas llojit);
- të presë peshkun në përmasat e duhura, sipas asortimentit;
- të marinojë copat e peshkut, sipas asortimentit;
- të vendosë në funksionim skarën sipas tipit të saj;
- të vendosë asortimentet e peshkut në skarë;

- të mbikqyrë procesin e gatimit me skarë sipas llojit të peshkut;
- të heqë asortimentet nga skara;
- të kryejë vlerësimin organo-shqisor të asortimentit të përgatitur;
- të dekorojë dhe prezantojë asortimentet me peshk skare, sipas rregullave të estetikës në gatim;
- të parapërgatitë peshkun për skuqje sipas llojit;
- të ngrohë yndyrën në temperaturën e duhur për skuqje (me tigan, fritezë);
- të vendosë asortimentet e peshkut me skuqje (me tigan, fritezë);
- të mbikqyrë procesin e gatimit me skuqje sipas llojit dhe madhësisë së peshkut;
- të heqë asortimentet nga skuqja;
- të kryejë vlerësimin organo-shqisor të asortimentit;
- të përgatitë asortimente të thjeshta shqiptare me peshk;
- të dekorojë dhe prezantojë asortimentet me peshk të skuqur, sipas rregullave të estetikës në gatim;
- të parapërgatitë peshkun për pjekje në furrë;
- të vendosë në funksionim furrën sipas manualit të përdorimit;
- të vendosë në tavë peshkun dhe përbërësit e tjerë sipas recetës;
- të vendosë tavën në furrë në temperaturën e duhur;
- të kryejë pjekjen e taves me peshk në furrë sipas recetës;
- të mbikqyrë procesin e gatimit me pjekje në furrë sipas llojit dhe madhësisë së peshkut;
- të heqë tavën nga furra;
- të kryejë vlerësimin organo-shqisor të asortimentit;
- të dekorojë dhe prezantojë asortimentet me peshk të furrës, sipas rregullave të estetikës në gatim;
- të zbatojë kushtet e ruajtjes së lëndëve të para dhe ndihmëse në kuzhinë sipas standardit;
- të zbatojë kushtet për garantimin e cilësisë gjatë përgatitjes së asortimenteve me peshk, në kuzhinë;
- të pastrojë vendin e punës;
- të pastrojë, sistemojë, dezinfektojë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e inventarizimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës në kuzhinë;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë përgatitjes së asortimenteve me peshk;
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë parapërgatitjes dhe gatimit të asortimenteve me peshk;

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë në kuzhinë;
- të respektojë procedurat për ndarjen e mbeturinave sipas llojit;
- të zbatojë procedurat për grumbullimin e vajit të përdorur për riciklim.

***instrumentet e vlerësimit***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 17 Nxënësi përgatit asortimente të thjeshta me prodhime deti.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës;
- të zbatojë rregulloren e brendshme të kuzhinës;
- të parapërgatitë vendin e punës;
- të përzgjedhë mjetet e punës;
- të zbatojë planin e prodhimit;
- të analizojë recetën përkatëse;
- të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse;
- të peshojë lëndëve e para dhe ndihmëse;
- të lajë dhe pastrojë prodhimet e detit dhe lëndët ndihmëse;
- të heqë guackat, sytë, cipën etj; (sipas rastit);
- të pastrojë dhe presë në përmasat e duhura prodhimet e detit të pastruara (sipas rastit);
- të kryejë larjen përfundimtare të prodhimeve të detit;
- të marinojë prodhimet e detit, sipas asortimentit;
- të parapërgatitë prodhimet e detit për asortimente me zierje;
- të përgatitë enën për zierje me prodhime deti dhe erzat përkatëse;
- të vendosë enën në zjarrë për zierje;
- të mbikqyrë procesin e zierjes së prodhimeve të detit sipas llojit;
- të heqë enën nga zjarri;
- të kullojë produktet e ziera;
- të kryejë vlerësimin organo-shqisor të prodhimeve të detit të ziera;
- të dekorojë dhe prezantojë prodhimet e detit të ziera, sipas rregullave të estetikës në gatim;
- të vendosë në funksionim skarën sipas tipit dhe manualit të përdorimit;
- të përgatitë asortimente me prodhime deti në skarë;
- të vendosë asortimentin në skarë;
- të mbikqyrë procesin e gatimit me skarë sipas llojit të prodhimeve të detit;
- të heqë produktet nga skara;

- të kryejë vlerësimin organo-shqisor të asortimentit;
- të dekorojë dhe prezantojë asortimentet me prodhime deti në skarë, sipas rregullave të estetikës në gatim;
- të parapërgatitë prodhimet e detit për skuqje sipas llojit;
- të ngrohë yndyrën në temperaturën e duhur për skuqje (me tigan, fritezë);
- të vendosë produktet për skuqje(me tigan, fritezë);
- të mbikqyrë procesin e gatimit me skuqje sipas llojit të prodhimeve të detit;
- të heq produktet nga skuqja sipas rregullit;
- të kryejë vlerësimin organoshqisor të asortimentit;
- të dekorojë dhe prezantojë asortimentet me prodhime deti të skuqura, sipas rregullave të estetikës në gatim;
- të zbatojë kushtet e ruajtjes së lëndëve të para dhe ndihmëse në kuzhinë sipas standardit;
- të zbatojë kushtet për garantimin e cilësisë gjatë përgatitjes së asortimenteve me prodhime deti, në kuzhinë;
- të pastrojë vendin e punës;
- të pastrojë, sistemojë, dezinfektojë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e inventarizimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës në kuzhinë;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë përgatitjes së asortimenteve me prodhime deti;
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë parapërgatitjes dhe gatimit të prodhimeve të detit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë në kuzhinë;
- të respektojë procedurat për ndarjen e mbeturinave sipas llojit;
- të zbatojë procedurat për grumbullimin e vajit të përdorur për riciklim.

***Instrumentet e vlerësimit***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 18 Nxënësi përgatit pandispanjë.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës;
- të zbatojë rregulloren e brendshme të kuzhinës;
- të parapërgatitë vendin e punës;
- të përzgjedhë mjetet e punës;
- të analizojë recetën përkatëse;
- të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse për pandispanjë;

- të verifikojë cilësinë e vezëve;
- të peshojë lëndët e para dhe ndihmëse;
- të ndajë të bardhat nga të verdhat e vezëve;
- të hedh të bardhat në enë me fund sferik dhe ti rrahë deri në krijimin e marenngës;
- të shtojë sasinë e duhur të sheqerit në marenngë dhe të bëjë rrahjen;
- të shtojë sasinë e duhur të të verdhave të vezëve në marenngë dhe të bëjë rrahjen;
- të shtojë sasinë e duhur të miellit në marenngë dhe të bëjë një përzierje të lehtësipas procesit teknologjik;
- të lyejë tavën me sasinë e duhur të yndyrës ose t'a përdore atë me letër furre;
- të hedhë masën e përgatitur në tavë;
- të përgatisë furrën me parametrat e duhur sipas manualit të përdorimit;
- të vendosë tavën në furrë;
- të pjekë pandispanjën në furrë, në temperaturën e duhur duke ndjekur procedurat e recetës;
- të heqë tavën nga furra;
- të vlerësojë defektet e pandispanjës;
- të presë (racionojë) copat e pandispanjës;
- të dekorojë pandispanjën;
- të zbatojë rregullat e ruajtjes së pandispanjës;
- të zbatojë kushtet e ruajtjes së lëndëve të para dhe ndihmëse në kuzhinë sipas standartit;
- të zbatojë kushtet për garantimin e cilësisë gjatë përgatitjes së pandispanjës, në kuzhinë;
- të pastrojë vendin e punës;
- të pastrojë, sistemojë, dezinfektojë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e inventarizimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës në kuzhinë;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë përgatitjes së pandispanjës;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së pandispanjës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë në kuzhinë;
- të respektojë procedurat për ndarjen e mbeturinave sipas llojit.

***Instrumentet e vlerësimit***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 19 Nxënësi përgatit kremrat bazë në kuzhinë.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës;
- të zbatojë rregulloren e brendshme të kuzhinës;
- të parapërgatitë vendin e punës;
- të përzgjedhë mjetet e punës;
- të analizojë recetën përkatëse;
- të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse;
- të peshojë lëndët e para dhe ndihmëse;
- të parapërgatitë lëndët e para dhe ndihmëse sipas recetës;
- të zbatojë hapat e procesit teknologjik sipas recetës;
- të përgatitë kremi karamel;
- të përgatitë kremi marengë;
- të përgatitë kremi e pastiçerisë;
- të përgatitë kremi e gjalpiti;
- të përgatitë kremi “shantilly“;
- të përgatitë kremi anglez;
- të përgatitë kremi çokollatë;
- të përgatitë mousse;
- të dekorojë kremrat;
- të zbatojë rregullat e ruajtjes së kremrave;
- të vlerësojë defektet e kremrave;
- të kryejë vlerësimin organo-shqisorë të kremrave të përgatitur;
- të zbatojë kushtet e ruajtjes së lëndëve të para dhe ndihmëse në kuzhinë sipas standardit;
- të zbatojë kushtet për garantimin e cilësisë gjatë përgatitjes së kremrave bazë, në kuzhinë;
- të pastrojë vendin e punës;
- të pastrojë, sistemojë, dezinfektojë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e inventarizimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës në kuzhinë;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë përgatitjes së kremrave;
- të zbatojë rregullat e higjienës, dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së kremrave;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë në kuzhinë;
- të respektojë procedurat për ndarjen e mbeturinave sipas llojit.

***Instrumentet e vlerësimit***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 20 Nxënësi përgatit ëmbëlsira të kuzhinës.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës;
- të zbatojë rregulloren e brendshme të kuzhinës;
- të parapërgatitë vendin e punës;
- të përzgjedhë mjetet e punës;
- të analizojë recetën përkatëse;
- të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse;
- të peshojë e lëndëve e para dhe ndihmëse;
- të parapërgatitë lëndët e para dhe ndihmëse sipas recetës;
- të zbatojë hapat e procesit teknologjik sipas recetës;
- të përgatitë ëmbëlsira me sherbet;
- të përgatitë biskota të ndryshme në kuzhinë;
- të përgatitë ëmbëlsira me fruta në kuzhinë;
- të përgatitë komposto në kuzhinë;
- të përgatitë reçelin në kuzhinë;
- të përgatitë kekun në kuzhinë (lloje të ndryshme);
- të përgatitë ëmbëlsira sipas krahinave të Shqipërisë;
- të kryejë vlerësimin organo-shqisor të ëmbëlsirave të përgatitura;
- të dekorojë ëmbëlsirat e kuzhinës, sipas rregullave të estetikës;
- të zbatojë kushtet e ruajtjes së lëndëve të para dhe ndihmëse në kuzhinë sipas standardit;
- të zbatojë kushtet për garantimin e cilësisë gjatë përgatitjes së ëmbëlsirave në kuzhinë;
- të zbatojë rregullat e ruajtjes së ëmbëlsirave në kuzhinë;
- të pastrojë vendin e punës;
- të pastrojë, sistemojë, dezinfektojë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e inventarizimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës në kuzhinë;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë përgatitjes së ëmbëlsirave në kuzhinë;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së ëmbëlsirave të kuzhinës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë në kuzhinë;
- të respektojë procedurat për ndarjen e mbeturinave sipas llojit.

***Instrumentet e vlerësimit***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

---

**zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve**

- por rekomandohen dhe vizita në biznese që ofrojnë shërbimin e kuzhinës.
- Mësuesi/Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet të përgatitjes së salcave të ftohta dhe të ëmbla, brumrave të ndryshëm, asortimenteve të thjeshta me mish, shpendë, peshk dhe prodhime deti si dhe ëmbëlsirave të kuzhinës, me përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve përkatëse.
  - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për veprimet parapërgatitore, si dhe për përgatitjen e sallatave, salcave të nxehta, të ftohta dhe të ëmbla, brumrave të ndryshëm, asortimenteve me mish, shpendë, peshk dhe prodhime deti si dhe ëmbëlsirave të kuzhinës, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur; Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
  - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.
  - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Kuzhinë reale ose kuzhinë e shkollës.
  - Kompleti i mjeteve, pajisjeve dhe makinerive të kuzhinës për përgatitjen e salcave të ftohta dhe të ëmbla, brumrave të ndryshëm, asortimenteve me mish, shpendë, peshk dhe fruta deti, asortimenteve me perime si dhe ëmbëlsirave tipike shqiptare të kuzhinës.
  - Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për përgatitjen e salcave të ftohta dhe të ëmbla.
  - Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për përgatitjen e brumrave të ndryshëm.
  - Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për përgatitjen e asortimenteve me mish dhe shpendë.
  - Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për përgatitjen e asortimenteve me peshk dhe prodhime deti.
  - Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për përgatitjen e ëmbëlsirave të kuzhinës.
  - Manuale, udhëzuesa, receta, menu dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-



## 6. Moduli “Shërbime në restorant dhe bar”

Drejtimi: Hoteleri -Turizëm

Niveli: II i KSHK

Klasa: 11

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	SHËRBIME NË RESTORANT DHE BAR	M-13-1353-22
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të parapërgatitur dhe shërbyer mëngjeset, për shërbimin e mëngjesit në dhomën e klientit, për të asistuar personelin gjatë shërbimeve në restorant, për të përdorur dhe mirëmbajtur mjetet e punës dhe pajisjet në bar si dhe për në përgatitur dhe shërbyer pije të ngrohta.	
Kohëzgjatja e modulit	68 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar kl.10 të drejtimit mësimor “Hoteleri - Turizëm”, niveli II i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi parapërgatit dhe shërben mëngjeset.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës;</li><li>- të komunikojë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët;</li><li>- të zbatojë sinjalistikën e përdorur në vendin e punës;</li><li>- të respektojë rregullat e higjienës personale në vendin e punës;</li><li>- të përgatitë sallën përpara fillimit të shërbimit sipas skemës së shërbimit;</li><li>- të vendosë tavolinat sipas rregullit;</li><li>- të organizojë dollapin sideboard sipas rregullit;</li><li>- të kryejë parapërgatitjet për shërbimin e mëngjesëve në restorant sipas rregullit;</li><li>- të kryejë përgatitjet në zonën ndihmëse sipas rregullit;</li><li>- të përzgjedhë mjetet për shtrim sipas rregullit;</li><li>- të shtrojë tavolinat sipas rregullit;</li><li>- të vendosë aksesoret në tavolinë sipas rregullave;</li><li>- të asistojë personelin gjatë kryerjes së kontrollit përfundimtar të sallës përpara fillimit të shërbimit;</li><li>- të parapërgatitë shtrimin e mëngjesëve sipas rregullit, para ardhjes së klientëve;</li><li>- të presë klientët për mëngjes sipas rregullave;</li></ul>	

- 
- të parapërgatitë shtrimin e mëngjesit të thjeshtë sipas rregullit;
  - të shërbejë mëngjesin e thjeshtë sipas rregullit;
  - të parapërgatitë shtrimin e mëngjesit kontinental sipas rregullit;
  - të shërbejë mëngjesin kontinental te klienti sipas rregullit;
  - të parapërgatitë shtrimin e mëngjesit anglez dhe amerikan sipas rregullit;
  - të shërbejë mëngjesin anglez dhe amerikan sipas rregullit;
  - të parapërgatitë shtrimin e mëngjesit me bufe;
  - të parapërgatitë ushqimet dhe pijet për bufenë e mëngjesit;
  - të parapërgatitë bufenë e pijeve sipas rregullit;
  - të parapërgatitë bufenë e ushqimit sipas rregullit;
  - të plotësojë ushqimet e përfunduara në bufe sipas rregullit;
  - të plotësojë pajisjet e ngrënies në bufe sipas rregullit;
  - të shtrojë tavolinat e klientëve sipas rregullit;
  - të orientojë klientët për përdorimin e aparatit të pijeve të ngrohta në bufenë e mëngjesit, kur është e nevojshme;
  - të parapërgatitë aparatën për shërbimin e lëngjeve të frutave në bufenë e mëngjesit;
  - të shërbejë në bufenë e mëngjesit;
  - të shërbejë pije të ngrohta në tavolinën e klientit, sipas rregullit;
  - të largojë pajisjet e përdorura sipas rregullit;
  - të rishtrijë tavolinat për shërbimin e radhës sipas rregullit;
  - të parapërgatitë brunch sipas rregullit;
  - të përcjellë klientët sipas rregullit;
  - të pastrojë tavolinat sipas rregullit;
  - të rregullojë sallën sipas rregullit;
  - të shtrojë sallën pas përfundimit të shërbimit sipas rregullit;
  - të kujdeset për sideboard sipas rregullit;
  - të zbatojë rregullat që garantojnë cilësinë e shërbimit te klienti;
  - të asistojë në kryerjen e inventarit të restorantit;
  - të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit në restorant;
  - të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në restorant.

***Instrumentet e vlerësimit***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

## **RM 2 Nxënësi shërben mëngjesin në dhomën e klientit.**

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës;
- të respektojë rregullat e higjienës personale në vendin e punës;
- të zbatojë sinjalistikën e përdorur në vendin e punës;
- të marrë porosinë për shërbim në dhomë të mëngjesit;
- të parapërgatitë mjetet dhe pajisjet për shërbim në dhomën e klientit;
- të parapërgatitë shërbimin e ushqimit në dhomën e klientit me karrocë;
- të përgatitë tabakanë për shërbimin e “early tea”;
- të zbatojë rregullat për hyrjen në dhomën e klientit duke zbatuar edhe shenjat konvencionale;
- të shërbejë me karrocë në dhomën e klientit;
- të shërbejë “early tea” në dhomën e klientit;
- të zbatojë rregullat që garantojnë cilësinë e shërbimit të klientit në dhomë;
- të komunikojë me etikë me klientët gjatë shërbimit në dhomë;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë parapërgatitjeve dhe shërbimit të ushqimeve në dhomën e klientit;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë parapërgatitjeve dhe shërbimit në dhomën e klientit.

### ***Instrumentet e vlerësimit***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

## **RM 3 Nxënësi asiston gjatë shërbimit në restorant me metodave të ndryshme shërbimi.**

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të respektojë rregullat e higjienës personale në vendin e punës;
- të zbatojë sinjalistikën e përdorur në vendin e punës;
- të dallojë metodat e shërbimit ndaj klientit;
- të presë klientët në sallë;
- të komunikojë me etikë me klientët në restorant;
- të shërbejë te klienti me pjatë;
- të zbatojë rregulla praktike për shërbimin me pjatë;
- të asistojë personelin gjatë shërbimit me kapak (cloche);
- të asistojë personelin gjatë shërbimit të ushqimit me pjatancë;

- të përdorë forlegerin;
- të asistojë personelin gjatë vendosjes së ushqimit nga pjatanca në pjatën e klientit;
- të përgatitë geridonin për shërbimin e ushqimit;
- të asistojë personelin gjatë përgatitjes së pjatave në geridon;
- të asistojë personelin gjatë shërbimit të pjatave nga geridoni te klienti;
- të parapërgatitë bufenë e pijeve;
- të parapërgatitë bufenë e ushqimit;
- të parapërgatitë aksesoret dekorativë për shërbimin bufe;
- të shërbejë ushqime në bufe në këmbë;
- të asistojë personelin gjatë shërbimit me pije në bufe në këmbë;
- të asistojë personelin gjatë shërbimit me pije në bufe ulur;
- të kryejë parapërgatitje dhe veprimtari që garantojnë cilësinë e shërbimit ndaj klientit;
- të përcjellë klientët sipas rregullit;
- të pastrojë tavolinat, sipas rregullit;
- të rregullojë sallën;
- të shtrojë sallën;
- të kujdeset për sideboard;
- të kujdeset për inventarin e përdorur;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë shërbimit në restorant;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit të restorantit.

***Instrumentet e vlerësimit***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 4 Nxënësi përdor dhe mirëmban pajisjet dhe mjetet e punës në bar.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës;
- të respektojë rregullat e higjienës personale në vendin e punës;
- të dallojë ndërtimin strukturor të banakut profesional;
- të marrë në dorëzim lëndët e para dhe ndihmëse për përgatitjet e pijeve të ngrohta në banak, sipas fletëporosisë;
- të parapërgatitë banakun e barit sipas rregullit;
- të vendosë pajisjet dhe mjetet e punës në bar sipas rregullit;
- të pastrojë dhe higjienizojë mjetet e punës në banakun e barit sipas rregullit;
- të pastrojë dhe dezinfektojë mjetet për shërbimin e klientit

- në banakun e barit sipas rregullit;
- të kontrollojë funksionimin e ekspresit në bar sipas manualit të përdorimit;
- të përdorë ekspresin sipas procedurës;
- të mirëmbajë dhe pastrojë ekspresin në bar sipas rregullit;
- të kontrollojë funksionimin e aparatit të filtrit sipas procedurës;
- të përdorë aparatën për përgatitjen e kafesë filtër sipas procedurës;
- të mirëmbajë dhe pastrojë aparatën për përgatitjen e kafesë filtër sipas procedurës;
- të kontrollojë funksionimin e aparatit moka sipas procedurës;
- të përdorë aparatën moka sipas procedurës;
- të mirëmbajë dhe pastrojë aparatën moka sipas procedurës;
- të përdorë aparatën e shkumëzimit të qumështit të ftohtë (neskafesë) sipas procedurës;
- të mirëmbajë dhe pastrojë aparatën e shkumëzimit të qumështit të ftohtë (neskafesë) sipas procedurës;
- të kontrollojë funksionimin e makinës për larjen e enëve (lavastovilje) sipas procedurës;
- të përdorë makinën për larjen e gotave dhe filxhanëve sipas procedurës;
- të vendosë gotat, filxhanët, kanat, lugët në makinë për larje sipas rregullit;
- të përzgjedhë solucionet për larjen e gotave, filxhanëve në makinën larëse;
- të mirëmbajë dhe pastrojë makinën larëse të mjeteve të punës sipas procedurës;
- të përdori makinën e akullit sipas procedurës;
- të mirëmbajë dhe pastrojë makinën e akullit sipas procedurës;
- të mirëmbajë banakun e barit, mjetet, pajisjet, aparatet dhe makinat e punës sipas rregullit;
- të kujdeset për ruajtjen e lëndëve të para dhe ndihmëse, sipas standardit;
- të kryejë parapërgatitje dhe veprimtari që garantojnë cilësinë e shërbimit ndaj klientit;
- të kujdeset për inventarin e mjeteve dhe pajisjeve të punës në bar;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit, mirëmbajtjes së pajisjeve dhe mjeteve të punës në bar.

***Instrumentet e vlerësimit***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

## **RM 5 Nxënësi përgatit dhe shërben pije të ngrohta;**

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës;
- të respektojë rregullat e higjienës personale në vendin e punës;
- të skicojë menunë e barit (kartën e pijeve të ngrohta);
- të përzgjedhë mjetet e punës për përgatitjen e pijeve të ngrohta sipas rregullit dhe llojit të pijes;
- të vendosë pajisjet, mjetet në banak sipas rregullave;
- të ngrohë ekspresin sipas rregullit dhe manualit të përdorimit;
- të ngrohë filxhanët sipas rregullit;
- të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse për përgatitjen e pijeve të ngrohta sipas recepturave;
- të përgatitë kafënë ekspres sipas procedurës;
- të përgatitë kafënë me qumësht sipas procedurës;
- të përgatitë kafënë filtër sipas procedurës;
- të përgatitë kafënë me aparat moka sipas procedurës;
- të përgatitë kafënë turke sipas procedurës;
- të përgatitë çajin sipas procedurës;
- të përgatitë kakaon sipas procedurës;
- të përgatitë çokolatën sipas procedurës;
- të përgatitë salepin sipas procedurës;
- të përgatitë neskafe sipas procedurës;
- të kryejë vlerësimin organoshqisor të pijeve të përgatitura;
- të përzgjedhë mjetet e punës për shërbimin e pijeve të ngrohta sipas llojit;
- të përgatitë tabakanë sipas rregullit;
- të vendosë pajisjet në tabaka sipas rregullave dhe procedurës;
- të mbartë tabakanë sipas rregullit;
- të parapërgatitë ushqime të vogla shoqëruese të pijeve të ngrohta në bar;
- të shërbejë pije të ngrohta sipas rregullit dhe procedurës;
- të përgatitë lëngje të thjeshta frutash në banak, sipas rregullit;
- të përdorë elementet e estetikës në shërbimin e pijeve/lëngjeve në banak;
- të zbatojë rregullat për mbledhjen së pajisjeve nga tavolina në banak;
- të sistemojë vendin e punës;
- të sistemojë mjetet dhe pajisjet e punës;
- të sistemojë lëndët e para dhe ndihmëse në banak;
- të mirëmbajë mjetet, pajisjet dhe aparatet e punës në banakun e barit;

- të zbatojë rregullat për sistemimin dhe ruajtjen e lëndëve të para dhe ndihmëse në bar;
- të kryejë parapërgatitje dhe veprimtari që garantojnë cilësinë e përgatitjes dhe të shërbimit ndaj klientit, në bar;
- të kujdeset për inventarin e mjeteve dhe pajisjeve në bar;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë përgatitjes së pijeve të ngrohta në bar;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së pijeve të ngrohta.

***Instrumentet e vlerësimit***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise reale pune të restorantit dhe barit, por rekomandohen dhe vizita në biznese që ofrojnë të njejtat shërbime.
- Mësuesi/Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për të parapërgatitur dhe shërbyer mëngjeset, për shërbimin e mëngjesit në dhomën e klientit, për të asistuar personelin gjatë shërbimeve në restorant, për të përdorur dhe mirëmbajtur mjetet e punës dhe pajisjet në bar si dhe për në përgatitur dhe shërbyer pije të ngrohta.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur për të parapërgatitur dhe shërbyer mëngjeset, për shërbimin e mëngjesit në dhomën e klientit, për të asistuar personelin gjatë shërbimeve në restorant, për të përdorur dhe mirëmbajtur mjetet e punës dhe pajisjet në bar si dhe për në përgatitur dhe shërbyer pije të ngrohta; Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, mjetet dhe pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Restorant dhe bar real ose restorant dhe bar i shkollës.
  - Komplet i mjeteve të shërbimit (argjendari, porcelane, qelqe, menage), mjeteve e pajisjeve të restorantit dhe barit.
  - Lëndë të para dhe ndihmëse për realizimin e pijeve të ngrohta dhe lëngjeve të frutave në bar.
  - Manuale, udhëzuesa, karta bari (menu) dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

## 7. Moduli “Shërbime në recepsion - 2”

Drejtimi: **Hoteleri - Turizëm**

Niveli: **II i KSHK**

Klasa: **11**

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	SHËRBIME NË RECEPTION - 2	M-13-1354-22
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer rezervime të thjeshta, regjistrimin dhe ç’regjistrimin e klientëve në hotel si dhe për të kryer këshillimin e klientëve për veprimtari kulturore, itinerare udhëtimi dhe turistike.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	36 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësi duhet të ketë përfunduar kl.10 të drejtimit mësimor “Hoteleri - Turizëm”, niveli II i KSHK.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<b>RM 1 Nxënësi kryen rezervime të thjeshta në recepsionin e hotelit.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të veshë uniformën në vendin e punës;</li><li>- të dallojë llojet dhe format e rezervimeve që kryen në recepsionin e hotelit;</li><li>- të zbatojë politikat e anulimit dhe garantimit të rezervimeve;</li><li>- të zbatojë kërkesat që duhen plotësuar për kryerjen e rezervimit në recepsionin e hotelit;</li><li>- të përdorë termat ndërkombëtare për tipet dhe kategoritë e dhomave dhe të shtretërve;</li><li>- të përdorë llojet e ofertave për klientin në recepsion;</li><li>- të negociojë me klientin;</li><li>- të kryejë rezervimin sipas etapave;</li><li>- të kryejë veprimet me dokumentet e identifikimit të klientit;</li><li>- të përdorë teknikat e dhënies së formularit të prenotimit të klienti, në rast rezervimi për grupe;</li><li>- të asistojë klientin në plotësimin e formularit të prenotimit;</li><li>- të kryejë konfirmimin e rezervimit për klientin sipas rregullave;</li><li>- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të</li></ul>	



---

ruajtjes së mjedisit në reception.

***Instrumentet e vlerësimit***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Nxënësi kryen rregjistrimin e klientit në receptionin e hotelit (Check In).**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të përshëndesë klientin me mirësjellje;
- të lexojë dokumentet e identifikimit të klientit;
- të konfirmojë detajet e rezervimit të klientit (*kohëzgjatjen e qëndrimit, tipin e dhomës, çmimin, mënyrën e pagesës etj*);
- të kryejë sipas rregullit informimin e klientit për orarin e mëngjesit dhe shërbimet e tjera në hotel (*palestër, sauna, pishinë, internet, free wi-fi*);
- të asistojë në plotësimin e kartës së rregjistrimit nga klienti;
- të kontrollojë saktësinë e plotësimit të kartës së rregjistrimit nga klienti;
- të marrë firmën nga klientët në kartën e rregjistrimit;
- të kryejë pajisjen e klientit me çelësin e dhomës sipas rregullit;
- të njoftojë portierin/ bell-boy për transportimin e bagazheve të klientit në dhomë (në rast se e kërkon vetë klienti);
- të kryejë hedhjen e të dhënave të klientit në rregjistër dhe sistemin kompjuterik;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në reception.

***Instrumentet e vlerësimit***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësi kryen ç'rregjistrimin e klientit në receptionin e hotelit (Check Out).**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të përshëndesë klientin me mirësjellje;
- të kontrollojë emrin e klientit dhe numrin e dhomës;
- të marrë prej klientit çelësin/ kartën e dhomës;
- të marrë opinionin mbi cilësinë e shërbimit në hotel;
- të verifikojë për shpenzime të minutës së fundit të kryera nga klienti (minibar, bar etj.);
- të paraqesë informacionin mbi shpenzimet totale të klientit

- për verifikim;
- të arkëtojë pagesën në rast se kryhet me para në dorë;
- të përgatitë faturën e shpenzimeve totale për klientin;
- të marrë firmën e klientit në faturën e përgatitur për të;
- të falendërojë klientin me urimin për një udhëtim të këndshëm;
- të njoftojë portierin/ bell-boy për përcjelljen e klientit;
- të mbyllë llogarinë e klientit dhe të ndryshojë statusin e dhomës;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në reception.

***Instrumentet e vlerësimit***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 4 Nxënësi orienton klientin në reception për guida në qytet/ zonë.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës;
- të interpretojë hartat gjeografike të qytetit/zonës;
- të interpretojë hartat administrative të qytetit/zonës;
- të interpretojë hartat turistike të qytetit/zonës;
- të interpretojë hartat rrugore të qytetit/zonës;
- të orientojë klientin për mënyrat e transportit në qytet/ zonë;
- të orientojë klientët për guidat e qytetit/zonës;
- të interpretojë broshurat promovuese të qytetit/zonës;
- të interpretojë fletëpalosje promovuese të qytetit/zonës;
- të informojë klientin për institucionet kulturore artistike të qytetit/zonës;
- të informojë klientin për veprimtaritë kulturore e artistike të qytetit/zonës;
- të informojë klientin për eventet sportive të qytetit;
- të informojë klientin për objektet e artit;
- të informojë klientin për muzeumet e qytetit/zonës;
- të informojë klientin për objektet e kultit në qytet/zonë;
- të informojë klientin për bibliotekat e qytetit/zonës;
- të informojë klientin për parqet e qytetit/zonës;
- të informojë klientin për qendrat e bukurisë/ spa;
- të informojë klientin për qendrat tregëtare të qytetit/zonës;
- të informojë klientin për llojet e turizmit të qytetit/zonës;
- të informojë klientin për agjensitë turistike të qytetit/zonës;
- të informojë klientin për restorantet e qytetit/zonës;
- të informojë klientin për pub-et, baret, diskotekat e qytetit/zonës;

- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në recepsion.

***Instrumentet e vlerësimit***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise reale pune, në recepsionin e shkollës, por rekomandohen dhe vizita në hotele që ofrojnë shërbimin e recepsionit.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për të kryer rezervime të thjeshta, regjistrimin dhe ç'rregjistrimin e klientëve në hotel, si dhe për të kryer këshillimin e klientëve për veprimtari kulturore, itinerare udhëtimi dhe turistike të qytetit/zonës.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer rezervime të thjeshta, regjistrimin dhe ç'rregjistrimin e klientëve në hotel, si dhe për të kryer këshillimin e klientëve për veprimtari kulturore, itinerare udhëtimi dhe turistike të qytetit/zonës; Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të mënyrave të prenotimit, rezervimit, regjistrimit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në lojë me role për kryerjen e informimit dhe këshillimit të klientit, si dhe të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të mënyrave të informimit dhe këshillimit të klientit;
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Recepsioni i shkollës, ose i hotelit.
  - Pajisje të recepsionit (kompjuter, faks, telefon, fotokopje, printer, skaner pasaportash).
  - Kancelari, formularë prenotimi, listë e dhomave, rregjistër prenotimi, kancelari, çelësa ose karta të detyrave.
  - Harta dhe guida të zonës.
  - Pajisje të guidës turistike (mikrofon, navigator, aplikacione).
  - Manuale, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

## 8. Moduli “Shërbime pastrimi - 2”

**Drejtimi:** Hoteleri – Turizëm  
**Niveli:** II i KSHK  
**Klasa:** 11

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	SHËRBIME PASTRIMI - 2	M-13-1355-22
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul praktik që aftëson nxënësit në përdorimin e pajisjeve dhe detergjentëve që përdoren në lavanteri si dhe për zhvillimin e aftësive paraktike të larjes, centrifugimit, tharjes dhe hekurosjes.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	33 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësi duhet të ketë përfunduar kl.10 të drejtimit mësimor “Hoteleri - Turizëm”, niveli II i KSHK.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<b>RM 1 Nxënësi pranon, parapërgatit, magazinon dhe dorëzon biankerinë.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të veshë uniformën në vendin e punës;</li><li>- të përgatitë vendin dhe mjetet e punës për pranimin e biankerisë sipas rregullit;</li><li>- të marrë në dorëzim biankerinë e hotelit sipas rregullit;</li><li>- të marrë në dorëzim rrobat e klientit sipas rregullit;</li><li>- të seleksionojë biankerinë sipas ngjyrave, përbërjes së materialit dhe shkallës së ndotjes;</li><li>- të seleksionojë biankerinë sipas sektorëve të hotelit;</li><li>- të etiketojë rrobat e klientëve;</li><li>- të lexojë etiketat e rrobave të klientëve;</li><li>- të testojë me dorë për kopsat, si dhe të bëjë testin e shoqërimit për ndjeshmërinë e ngjyrës;</li><li>- të kryejë trajtimin e njollave të ndryshme sipas rregullit;</li><li>- të transportojë dhe klasifikojë sipas procesit biankeritë dhe rroba të tjera për larje;</li><li>- të përzgjedhë programin larës sipas etiketës;</li><li>- të zbatojë procesin e tharjes së rrobave;</li><li>- të seleksionojë rrobat sipas procesit të hekurosjes;</li><li>- të hekurosë rrobat sipas treguesit të etiketës;</li><li>- të paketojë dhe sistemojë rrobat e klientit sipas rregullit;</li><li>- të palosë biankerinë për hekurosje sipas rregullit;</li></ul>	

- të transportojë biankerinë e pastër në vendin e magazinimit sipas rregullit;
- të stivosë biankerinë dhe rrobat sipas rregullit të përcaktuar;
- të dorëzojë sipas rregullit biankerinë sipas sektorëve me dokumentacion përkatës;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së vendin e punës.

***Instrumentet e vlerësimit***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Nxënësi kryen procesin e larjes së biankerisë në lavanteri.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të verifikojë funksionimin e pajisjeve larëse;
- të seleksionojë biankeritë për larje;
- të transportojë biankeritë e seleksionuara pranë makinave larëse;
- të vendosë biankeritë në pajisjen larëse;
- të përzgjedhë detergjentet larës sipas llojit të biankerive dhe etiketave të tyre;
- të llogaritë dozimin e detergjenteve sipas peshës, llojit të rrobave dhe kapacitetit të makinerisë;
- të vendosë detergjentet në vendet e përcaktuara sipas rregullit;
- të përcaktojë programet e larjes sipas llojit dhe etiketës;
- të nxjerrë rrobat nga makina larëse;
- të transportojë biankeritë për procesin e tharjes;
- të përzgjedhë programet e tharjes sipas llojit të biankerisë dhe etiketës;
- të mirëmbajë pajisjet;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në lavanteri.

***Instrumentet e vlerësimit***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësi hekuros biankerinë në lavanteri.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të verifikojë funksionimin e pajisjeve hekurosëse;
- të transportojë biankeritë pranë pajisjeve të hekurosjes;
- të programojë mënyrën e hekurosjes sipas llojit të hekurit;
- të hekurosë pecetat;
- të hekurosë mbulesat;

- të hekurosë çarçafët;
- të hekurosë rrobat e klientëve dhe personelit sipas treguesit të etiketës;
- të paketojë dhe sistemojë biankeritë dhe rrobat e klientit në vendet përkatëse;
- të transportojë biankeritë në vendet e magazinimit;
- të mbyllë makinerinë në përfundim të procesit të hekurosjes;
- të mirëmbajë pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në vendin e punës.

***Instrumentet e vlerësimit***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve**

- Ky modul duhet të trajtohet në lavanerinë e shkollës dhe në lavaneri të hoteleve.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të larjes, përgatitjes dhe dozimit të detergjentëve, programimin e pajisjeve për punë si dhe temperaturat e nevojshme, të larjes, tharjes, hekurosjes.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e proceseve të larjes, centrifugimit, tharjes dhe hekurosjes.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës dhe përdorimin e pajisjeve në lavaneri.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Repart lavanerie për pastrimin e rrobave të palara dhe tharjen e tyre.
  - Mjete pune dhe pajisje që përdoren në lavaneri.
  - Detergjentë për larje dhe solucione për trajtimin e njollave.
  - Biankeri të llojeve të ndryshme për demonstrim;
  - Hekura dore, rrul hekurosës, rafte dhe karroca (rafte) magazinimi.
-

## 9. Moduli “Komunikimi në gjuhën angleze në hoteleri turizëm - 1”

Drejtimi: **Hoteleri -Turizëm**

Niveli: **II i KSHK**

Klasa: **11**

### PËRSHKRUESI I MODULIT

<b>Titulli dhe Kodi</b>	<b>KOMUNIKIMI NË GJUHËN ANGLEZE NË HOTELERI TURIZËM - 1</b>	<b>M-13-1816-22</b>
-------------------------	---	---------------------

**Qëllimi i modulit** Një modul që aftëson nxënësit për të komunikuar me etikë profesionale, në gjuhën angleze, gjatë kryerjes së veprimtarive profesionale në mjediset e hotelit, të recepsionit, të barit, të restorant si dhe gjatë shërbimit në dhomë.

**Kohëzgjatja e modulit** 33 orë mësimore

**Niveli i parapëlqyer për pranim** Nxënësi duhet të ketë përfunduar kl.10 të drejtimit mësimor “Hoteleri - Turizëm”, niveli II i KSHK.

**Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 1 Nxënësi komunikon në gjuhën angleze në recepsion.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- a) Në lidhje me informimin e klientit, në gjuhën angleze:
- të informojë klientin “walk-in” (ballë për ballë) për ofertën e dhomave (llojet, kategoritë dhe çmimet);
  - të informojë klientin “walk-in” për mjediset dhe shërbimet që ofron hoteli (pishinë, sauna, palestër, masazhe, *internet*, *free wi-fi*) etj.);
  - të informojë klientin nëpërmjet telefonit, për ofertën e dhomave (llojet, kategoritë dhe çmimet);
  - të informojë klientin nëpërmjet telefonit, për shërbimet që ofron hoteli (pishinë, sauna, palestër, masazhe etj.);
  - të informojë klientin nëpërmjet e-mail dhe platformave dixhitale (whatsapp, facebook, instagram etj.), për ofertën e dhomave (llojet, kategoritë dhe çmimet);
  - të informojë klientin nëpërmjet e-mail dhe platformave dixhitale (whatsapp, facebook, instagram etj.) për shërbimet që ofron hoteli (pishinë, sauna, palestër, masazhe etj.).
- b) Në lidhje me komunikimin në gjuhën angleze për rezervimin:
- të komunikojë me klientët “walk-in” për detajet e

- 
- rezervimit të dhomave, (kohëzgjatjen e qëndrimit, tipin e dhomës, çmimin, mënyrën e pagesës etj.);
- të komunikojë me klientët “walk-in” për rezervimin e shërbimeve që ofron hoteli (pishinë, sauna, palestër, masazhe, internet, free wi-fi) etj.);
  - të komunikojë me klientët “walk-in” për plotësimin e formularit të prenotimit;
  - të komunikojë me klientët nëpërmjet telefonit për detajet e rezervimit të dhomave, (kohëzgjatjen e qëndrimit, tipin e dhomës, çmimin, mënyrën e pagesës, etj.);
  - të komunikojë me klientët nëpërmjet telefonit për rezervimin e shërbimeve që ofron hoteli (pishinë, sauna, palestër, masazhe, internet, free wi-fi) etj.);
  - të komunikojë me klientët nëpërmjet e-mail dhe platformave dixhitale, për rezervimin e dhomave;
  - të komunikojë me klientët nëpërmjet e-mail dhe platformave dixhitale për rezervimin e shërbimeve që ofron hoteli (pishinë, sauna, palestër, masazhe, internet, free wi-fi) etj.).
- c) Në lidhje me komunikimin në gjuhën angleze për regjistrimin (check-in):
- të komunikojë me klientët prezentë, për regjistrimin në dhoma sipas detajeve (kohëzgjatjen e qëndrimit, tipin e dhomës, çmimin, mënyrën e pagesës etj.);
  - të komunikojë me klientët prezentë, për regjistrimin në shërbimet që ofron hoteli (pishinë, sauna, palestër, masazhe, internet, free wi-fi), etj.);
  - të komunikojë me klientët prezentë në plotësimin e saktë të kartës së regjistrimit, në marrjen e firmës nga klienti dhe pajisjen e tij me çelësin e dhomës sipas rregullit.
- d) Në lidhje me komunikimin në gjuhën angleze për dhënien e asistencës gjatë qëndrimit:
- të komunikojë me klientët gjatë shoqërimit në dhomë;
  - të komunikojë me klientët gjatë transportit të bagazheve;
